



Prishtinë, 30 mars 2011
Kodi i ZRRE-së: V_342_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e dhëna në Nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenin 41 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);

Në seancën e mbajtur me datë 30 mars 2011, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHEN kriteret për vlerësimin e konkurrencës në furnizim me energji elektrike

Arsyetim

1. Për vendosjen e Krierve të vlerësimit të konkurrencës për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e lëshuara dhe të publikuara në ueb faqen e saj, si:
 - Raportin Konsultativ mbi Kriteret për matjen e konkurrencës efektive në furnizimin me energji elektrike, dhe
 - Shqyrtimin e komenteve, përgjigjet e ZRRE-së mbi “Komentet për kriteret e konkurrencës”, publikuar më 29 mars 2011.
2. ZRRE, pas vlerësimit të këtyre dokumenteve dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Konkurrenca efektive në furnizimin me energji elektrike do të vlerësohet për tregjet në vijim:

1. Shfrytëzuesit më të mëdhenj të energjisë: konsumatorët e kyçur në nivelin 110 kV e më lartë (kategoria tarifore 0);
2. Shfrytëzuesit energjisë në tensionin e mesëm: konsumatorët e kyçur në nivelet 35 kV dhe 10 (20) kV (kategoritë tarifore 1 dhe 2);
3. Shfrytëzuesit e energjisë në tensionin e ultë: konsumatorët e kyçur në nivelin 0.4 kV (kategoria tarifore 3); dhe
4. Shfrytëzuesit e vegjël të energjisë në tensionin e ultë (kategoritë tarifore 4 dhe 8).



- III. Sipas pikës II të këtij Vendimi një treg relevant konsiderohet konkurrent nëse i përmbush kushtet në vijim:
- Numri i furnizuesve në treg relevant, duke mos përfshirë furnizuesin publik, duhet të jetë 3 apo më shumë; dhe
 - Pjesa e tregut relevant të shërbyer nga furnizuesit, duke mos përfshirë furnizuesin publik, duhet të tejkalojë 30%.
- IV. Furnizuesi aktiv që përdoret për vlerësimin e kriterit të pikës III të këtij Vendimi është ai që në vitin e kaluar ka furnizuar së paku 10% të tregut përkatës, matur sipas vëllimeve totale të konsumuara të energjisë.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cila do që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar